



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:261530

Datë: 12.02.2025

Numri i dokumentit: 06842522

**C.nr.403/2019**

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇA-** Departamenti i Përgjithshëm civilo-juridik me gjyqtarin Bekim Avdimetaj ne çështjen kontesti morë të paditëses M, e M, dhe P. H, me seli në P, qe kanë përfaqësuar nga Avokatura Shtetërorë e Ministrisë të Drejtësisë përfaqësuesi më autorizim Nam Krasniqi nga Prishtina, kundër të paditurit Xh. K, me vendbanim rruga Isa dhe Valdet Kuçi ne D, të cilin me autorizim e ka përfaqësuar avokati Faruk Binakaj nga Peja , me objekt kontesti kompensim demi, më vlerë të objektit të kontestit 4.221.00 euro ,gjykata pas përfundimit te seancës te shqyrtimin kryesor publike të mbajtur me datën 04.02.2025 në prezencën e te autorizuarve ndërgjyqësve te përpiluar me datën 11.02.2025 mur ketë :

**A K T G J K I M**

**I.APROVOHET** ne tersi kërkesë padia e paditëses M, e M, dhe P. H, me seli në P, qe kanë përfaqësuar nga Avokatura Shtetërorë e Ministrisë të Drejtësisë përfaqësuesi më autorizim Nam Krasniqi nga Prishtinë.

**II.DETYROHET** i paditurit Xh. K, me vendbanim rruga Isa dhe Valdet Kuçi ne D, që paditëses M, e M, dhe P. H, me seli në P, në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej 4.221.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit e deri në pagesën definitive e nen kërcënimit të përmbartimit .

**III.** Secila pale veç e veç i barte shpenzimet e procedurës kontesti morë .

**A r s y e t i m**

Paditësja M, e M, dhe P. H, me seli në P, në ketë gjykatë me datën 11.11.2019 ka paraqitur padi për kompensim të dëmit kundër te paditurit me vendbanim rruga Isa dhe Valdet Kuçi ne Deçan me pretendimet si vijon : pala e paditur me datën 17.09.2018 rreth orës se mëngjesit vendin e quajtur Livadhi i Bidit ne Bjeshkët e Nemuna i cili administrohet nga parku kombëtar Bjeshkët e Nemuna dhe ka prerë 26 cop trungje të llojit “bre” ne vëllimin prej 12.06 m3 dhe i ka shkaktuar dëme padisës na vlerë prej 4.221.00 euro , prandaj pala paditëse ju ka drejtuar Gjykatën me padi për kompensim dëmit.

Përfaqësuar nga Avokatura Shtetërorë e Ministrisë të Drejtësisë përfaqësuesi më autorizim Nam Krasniqi qe ka përfaqësuar paditësen gjatë ë shqyrtimit kryesor dhe ne fjalën e tij përfundimtare me date 04.02.2025 ka mbetur pranë padis dhe kërkesës. Se sa duke deklaruar se baza juridike e kompensimit e dëmit janë paraqitur ne provat e paraqitura pranë kësaj gjykate. Duke kërkuar nga ana e gjykatës që pas administrimit të provave të merret aktgjykim me të cilin aprovohet padia dhe kërkesa e saj , ndërsa sa i përket kamatës ligjore dhe shpenzimet procedurale ka hequr dorë .

I autorizuari i paditurit av. Faruk Binakaj gjatë shqyrtimit kryesor dhe ne fjalën e tij përfundimtare me date si me larte ka deklaruar se e kundërshtoj ne tërësi kërkesëpadinë e padisës duke aluduar se nuk dihet sasia dhe lloji i demit të pësuar nuk ka ndonjë vlerësim për demet që janë pësuar nga ana e paditurit. Pasi që nuk ka ndonjë ekspertizë lidhur me këtë çështje, andaj ka propozuar që të refuzohet kërkesë padinë e padisës si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata me qellim të nxjerrjes së plotë të gjendjes faktiket ka marruar këto prova : Rregullorja e MMHP nr.01/2015 e Ministrisë e Planifikimit hapësinore e dt.19.03.2015 me numër protokollit 1250/15, M-01, Aktgjykimi me numër P.nr 183/2018 e dt.15.01.2019 i plotfuqishëm me dt.11.03.2019. Pasi që gjykata beri vlerësimin të provave një nga një dhe të gjitha së bashku ne mbështetje me nenin 8 LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Për Gjykatën nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesë padisë pasi që kjo vërtetohet me aktgjykimi me numër P.nr 183/2018 e dt.15.01.2015, ku vërtetohet se pala e paditur është dënua nga Gjykata Themelore në Pejë Dega në Deçan për veprën penale “Vjedhje Pylli” nga neni 358 par 2 KPRK-së.

Gjykata lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit gjykata u lëshuar ne rregulloren e MMPH të Kosovës me numër 01/2015 ku shihet tabela dhe vlera e dëmit në shtojcën numër 12 pika 1 “Hormoqi dhe Bredhi”.

Andaj Gjykata lidhur me bazën juridike gjykata e vlerësojë dhe vendosi ne nenin 136 par 1 LMD-së “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.” Po ashtu në bazë të nenit 140 LMD-së (Ligjit për Mardheniet Detyrimeve ) I cili parashef se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”Sipas vlerësimit të gjykatës dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë Dega në Deçan pala e paditur ishte shpallur fajtor me çka vërtetohet se padituri ka shkaktuar dëm pales paditese ketu MMPH me seli në Prishtinë. Po ashtu gjykata bazuar ne nenin 14 LPK-së (Ligjit të procedurës Kontestimore) I cili parashef se “ Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.” Dhe në bazë të nenit 169 LMD-së I cili parashef se “1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t`ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t`i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme te ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet te detyrimeve . Andaj nga të lartcekurat gjykata vlerësoj se ne rastin konkret gjendja ne kthimin e me parshem nuk është I mundur andaj e detyron palen e paditur që të përmbush obligimin e kompensimit të demit në të holla.

Gjykata lidhur me kumatën ligjore nuk vendosi sepse përfaqesuesi I padises gjatë séances te shqyrtimit kryesor dhe ne fjalën e tij përfundimtare kishte hequr dorë nga kërkesa për kumatën ligjore prej 8% .

Gjykata murr parasyshe edhe pretendimet e pales së paditur mirpo që nuk murrën influencën që të vendoset ndryshe pasi që të gjitha ato masa drurore janë të llojit bre dhe nuk janë llojit tjetër në menyrë që të ketë paqartesi ne sasin e tyre llojin dhe shumën, andaj nga keto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

Gjykata lidhur me shpenzimet procedural ka vendos si ne piken III te dispozitivit të ketij aktgjykimi në bazë të nenit 450 Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedure Kontestimore qe secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Nga sa u tha me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi .

### **GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA NË DEÇAN**

**Gjyqtari**

Bekim Avdimetaj

### **KËSHILLË JURIDIKE**

*Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankesë  
në afatë prej pesëmbëdhjetë(15)ditëve nga dita e pranimi  
pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykatë.*